



TEL: +38349510007 dhe +38344364106

e mail: kosovajudo@hotmail.com

RAPORT

Seminari per Antidoping

27 Janar 2018

Peje, Kosove

Ne palestren e xhudos "Ippon" ne Peje u mbajt seminari per Anti Doping.

Ky seminar u udhehoq nga xhudistja Nora Gjakova.

Pjesemarres ishin 30 xhudiste te grupmoshes U14 e deri ne Senior si dhe 10 trajner.

Ky seminar u mbajt me qellim te ndergjegjesimit te xhudisteve dhe trajnereve rreth Kodit te Anti Dopingut te Wada-se, Federates Boterore te Anti Dopingut.

Nora se bashku me disa xhudiste te tjere pjesemarres ne gara zyrtare te EJU dhe IJF me dhjetra here iu jane nenshtuar procedurave te dopingut ne gara apo gjate pergaditjeve.

Momentalisht nga Federata jone jane 4 xhudiste (Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Akil Gjakova, Distria Krasniqi) te perzgjedhur nga Federata Boterore e xhudos dhe WADA per te raportuar vendndodhjen ne sistemin ADAMS.

Gjate ketij Seminari u diskutuan shume ceshtje te rendesishme rreth Anti Dopingut sikur:

Lista e substancave dhe metodave te ndaluara ne gara dhe jashte garave, vetem ne gara dhe per sporte specifike

Perjashtimet per perdorime terapeutike-Ne rast te perdorimit te substancave apo metodave qe jane te listuara si te ndaluara nga WADA

IJF Registered Testing Pool (RTP)- Perzgjedhja nga IJF (Federata Boterore e xhudos) per te raportuar permes sistemit ADAMS vendndodhjen gjate nje viti ADAMS System-Njoftimi me menyren e perdorimit te sistemit ADAMS
Kontrolla e Dopingut-Procedurat

Nder te tjera u diskutua edhe rreth perdorimit te disa ilaqeve te cilat pa ndonje kufizim mund te blihen ne farmaci por mund te permbajne substanca te ndaluara nga WADA.

Nje prej shembujve te shumte qe u diskutua ishte pluhuri Tylool Hot (qe zakonisht blihet kunder gripit) qe permban substancen pseudoephedrine te ndaluar nga WADA gjate dhe jashte garave.

U kerkua nga te gjithë sportistet qe te kene kujdes gjate perdorimit apo blerjes te cfaredo medikamenti, fillimisht duke u konsultuar me farmacistin nese eshte ne listen e substancave te ndaluara apo edhe duke e shikuar listen zyrtare te WADA-se per Anti-Doping.

Ne shtetet perendimore secila farmaci permban listen e substancave te cilat mund te permbajne Doping por e njejta nuk vlen ne Kosove sepse farmacite nuk permbajne informacione te duhura rreth ceshtjes se dopingut.

Seminari perfundoj me sukses dhe te gjithë pjesemarresit u njoftuan hollesishte me kodin e Anti-Dopingut.

FEDERATA E XHUDOS SE KOSOVES

PEJE, 27 JANAR

